



Prania / Ditezuar Prisjena / Priseta Presence / Ditsore	11 - 01 - 2024	4	viti god year
Organ / Shënia Organ / Jednica Org. unit	SKINSHICK	212/2024	Sasia Kolicina Quantity
			116



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.1393/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar; Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj Demi- anëtarë; me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1393/2023, të datës 08.11.2023, të parashtruar nga ankuesi në çështjen juridike "kontestim konkursi", kundër Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1; nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur me datë 11.01.2024, njëzëri mori këtë:

**V E N D I M**

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1393/2023, e datës 08.11.2023, e parashtruar nga ankuesi
- II. Anulohet Njoftimi i datës 11.10.2023, i Njësisë së Burimeve Njerëzore, të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, si dhe Rezultatet përfundimtare të vlerësimit të datës 09.10.2023, ndërsa, *mbesin në fuqi* veprimet administrative të ndërmarra në procedurën paraprake deri tek testin me shkrim.
- III. Detyrohet Komisioni i Vlerësimit për Ngritjen në Detyrë që në pajtim me pikëpamjet juridike si në arsyetimin e këtij vendimi, të bëjë rivlerësimin e jetëshkrimit si dhe rivlerësimin nëpërmjet një intervistës me gojë të ankuesit.
- IV. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarrë të gjithë veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi siç përcaktohet në pikën II dhe III të dispozitivit.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## A r s y e t i m

Ankuesi (tutje vetëm ankuesi), më datë 08.11.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, kundër veprimeve dhe mosveprimeve të Komisionit për Ngritje në Detyrë dhe vlerësim jo korrekt, lidhur me procesin e rekrutimit ngritje (avancim) në detyrë për pozitën "Drejtor i Departamentit të Tregtisë" në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se Komisioni i Vlerësimit për Ngritjen në Detyrë nuk ka vepruar sipas pikëpamjeve juridike dhe vendimmarrjes të Vendimit të Këshillit të datës 08.09.2023, respektivisht Komisioni në fjalë pas rivlerësimit ka bërë ulje të pikëve nga 5.33 në 4 pikë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej Këshilli), bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 15.11.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ndërsa kjo e fundit më datë 20.11.2023, ka përcjell shkresat lidhur me çështjen në procedurë të vendosjes.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:* Ankesën me numër protokolli 6930/2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e Këshillit A.nr.999/2023 të datës 08.09.2023; E-mailin e datës 08.11.2023 dërguar nga ankuesi në Këshill; Njoftimin e datës 10.10.2023 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të MINT; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 15.11.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 20.11.2023; E-mail i datës 15.11.2023 dërguar nga për me korrespondencën e bashkangjitur prej 2 faqesh; Konkursin e datës 26.01.2023; Njoftimin e datës 25.09.2023; E-mailin e datës 26.09.2023 dërguar nga ZKP.MINT për etj; E-mailin e datës 26.09.2023 dërguar nga për me korrespondencën e bashkangjitur prej 3 faqesh; E-mailin e datës 04.11.2023 dërguar nga për me korrespondencën e bashkangjitur prej 9 faqesh; E-mailin e datës 04.11.2023 dërguar nga V.R-V për ankuesin; Formularin e renditjes përfundimtare të kandidatëve i datës 09.10.2023; Njoftimi i datës 11.09.2023; Njoftimin e datës 11.10.2023; E-mailin e datës 16.11.2023 nga ZKP.MINT për etj; E-mailin e datës 11.11.2023 dërguar nga për ankuesin; E-mailin e datës 11.11.2023 dërguar nga për Këshillin.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishtëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së ankesa e ankuesit është e bazuar, sepse:

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë se Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (tutje MINT), me datë 26.01.2023, ka publikuar në sistem qendror elektronik (SIMBNJ), Konkursin për Ngritje (avancim) në Detyrë, me numër reference RN00010807, për pozitën e punës "Drejtor i Departamentit të Tregtisë", e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi. Konkursi ka qenë i hapur për aplikim nga data 10.02.2023 deri me 17.02.2023, ndërsa sipas listës së aplikantëve rezultoi se numri i kandidatëve aplikues ka qenë dy, me ç'rast procedura ka vazhduar vetëm me një kandidat në këtë rast ankuesin, si kandidat i vetëm që ka plotësuar kriteret e pozitës së shpallur.

Me tej nga shkresat e lëndës Kolegji ka gjetur së ankuesi i është nënshtruar të gjitha fazave të vlerësimit përkatësisht vlerësimit me shkrim (testit) si dhe intervistës me gojë të mbajtur me datë 30.03.2023, mirëpo Komisioni i Vlerësimit për Ngritje në Detyrë (referuar ne tekstin e mëtejme Komisioni i Vlerësimit) i themeluar me Vendimin Nr.Ref.02/72, të datës 14.03.2023, të Sekretar i Përgjithshëm të MINT-it, nuk kishte përfunduar procesin e vlerësimit dhe së ankuesi nuk ishte njoftuar me rezultatin e vlerësimit. Pasi që nuk ka pranuar ndonjë njoftim lidhur me rezultatet e vlerësimit, ankuesi me datë 27.04.2023 parashtron ankesë në Këshill për shkak të mos përmbylljes së procesit rekrutues, ndërsa, Këshilli me Vendimin me numër A.nr.677/2023, të datës 26.06.2023, ka aprovuar ankesën e ankuesit të datës 27.04.2023, ka anuluar Vendimin me numër protokolli 3025/02, të datës 26.05.2023, të Komisionit të Vlerësimit si dhe renditjen përfundimtare të kandidatëve të datës 16.05.2023, duke obliguar këtë të fundit që të bëjë rivlerësim të jetë shkrimit të ankuesit dhe të zhvillojë vlerësim të ri përmes intervistës me gojë.

Me tej nga shkresat e lëndës rrjedhë së Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore e MINT-it, më datë 12.07.2023 ka nxjerrë njoftimin se procedura për Ngritje -Avancim në Detyrë për pozitën Drejtor i Departamentit të Tregëtisë, i publikuar me datë 26.01.2023, përfundon pa kandidat fitues edhe pas rivlerësimit nga ana e Komisionit Vlerësues në bazë të vendimit të Këshillit, kurse po në të njëjtën ditë ka njoftuar ankuesin se : *janë publikuar rezultate përfundimtare të vlerësimit për shpalljen me numër reference RN00010807, në SIMBNJ. Kandidatet e pakënaqur ndaj rezultatit të vlerësimit konkurrimit kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë brenda 30 ditësh në KPSHCK, nga data e pranimit të këtij njoftimi...*

Ankuesi brenda afatit ligjor kishte parashtruar ankesë në Këshill, kundër veprimeve dhe mosveprimeve të Komisionit për ngritje në detyrë dhe vlerësim jo korrekt, lidhur me procesin e rekrutimit ngritje (avancim) në detyrë për pozitën "Drejtor i Departamentit të Tregëtisë" në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë. Shton se bazuar në dokumentacionin e vlerësimit të siguruar sipas kërkesës për qasje në dokumente zyrtare është vërtetuar së Komisioni i Vlerësimit ka bërë ndryshime të vlerësimeve, përkatësisht, Komisioni i Vlerësimit ka bërë vlerësim me datë 23.03.2023 dhe 30.03.2023 ku janë bërë ndryshime të pikëve të vlerësimeve lidhur me biografinë dhe vlerësimin e intervistës me gojë, andaj, kërkon që Këshilli të merr si të mirëqenë vlerësimin e datës 20.03.2023, sipas të cilit ankuesi ka arritur 60.66 pikë, si të mjaftueshme për tu shpallur kandidat fitues dhe në këtë mënyrë ankuesit ti njihet e drejta e fituar sipas ligjit.

Në kuptim të kuadrit ligjor si lartë si dhe duke marr parasysh pretendimet ankimore të ankuesit, Kolegji nga analizimi i provave materiale të parashtruara nga palët në procedurë dhe analizimit të dispozitave ligjore në fuqi të ligjit material, kishte konstatuar se Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë nuk ka zbatuar Vendimin e Këshillit A.nr.677/2023 të datës 23.06.2023, me të cilin ishte obliguar Komisioni i Vlerësimit, që në rishqyrtim të rivlerësonte jetëshkrimin e ankuesit pasi që sipas Këshillit ishte vërejtur nënvlerësim i jetëshkrimit dhe të zhvillonte vlerësim të ri përmes intervistës me gojë, duke u udhëzuar Komisionin e Vlerësimit që të mbante evidencë përkitazi me pyetjet e parashtruara dhe vlerësimin e ankuesit nga secili anëtar veç e veç. Mirëpo, bazuar në provat e përcjella nga organi i punësimit sipas përgjigjes në ankesën A.nr.999/2023, rezulton se me asnjë provë nuk argumentohet që Komisioni i Vlerësimit ka zhvilluar intervistë më shkrim në procedurë të rishqyrtimit dhe ka bërë rivlerësim të jetëshkrimit, rrejdhimisht, Komisioni i Vlerësimit në procedurë të rishqyrtimit i është shmangur ndërmarrjes së veprimeve administrative të propozuara nga Këshilli sipas Vendimit A. nr.677/2023, ngase sipas Rezultateve përfundimtare të datës 12.07.2023 kemi vlerësim të përsëritur përkatësisht të njëjtë sikurse me vlerësimin e datës 16.05.2023, ku ankuesi ka akumuluar gjithsej 57.33 pikë.

Tutje Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit të ankesës së ankuesit të datës 17.07.2023 dhe analizimit të dispozitave ligjore në fuqi me datë 08.09.2023 ka nxjerrë Vendimin A.nr.999/2023 dhe numër protokolli:6039/2023 përmes të cilit e kishte aprovuar ankesën e ankuesit si të bazuar ndërsa ka anuluar Njoftimin e datës 12.07.2023 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, lidhur me përfundimin e procedurës së avancimit, me numër reference RN00010807 si dhe rezultatet përfundimtare të vlerësimit të datës 12.07.2023, ndërsa ka lënë në fuqi veprimet administrative të ndërmarra në procedurën paraprake dhe testin me shkrim, kurse është obliguar Komisioni i Vlerësimit për Ngritjen në Detyrë që në pajtim me pikëpamjet juridike si në arsyetimin e Vendimit A.nr.999/2023 të bëjë vlerësimin e jetëshkrimit si dhe vlerësimin nëpërmjet një interviste me gojë të ankuesit.

Pas veprimeve të ndërmarra procedurale nga Komisioni i vlerësimit, Kolegji i Këshillit duke iu referuar formularit për renditjen përfundimtare të datës 09.10.2023 konstatoi se ankuesi në rivlerësim është poentuar me 4 pikë për jetëshkrimin ndërsa me 2.33 pikë në intervistim me gojë, ashtu që i njëjti pasi që paraprakisht në testin me shkrim kishte arritur 51, rezulton se gjithsejtë ka grumbulluar 57.33 pikë të cilat janë të pamjaftueshme për tu emëruar në pozitën për të cilën është zhvilluar procedura e rekrutimit sikurse përcaktohet edhe me dispozitat e nenit 49 paragrafi 2 ndërlidhur me nenin 63 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se: *"Kandidati që është vlerësuar me më shumë pikë dhe që ka marrë të paktën gjashtëdhjetë (60) pikë është kandidati fitues dhe ka të drejtën të emërohet në pozitën e lirë për të cilën është zhvilluar konkurimi."*, dhe për të njëjtin rezultat është njoftuar edhe ankuesi përmes njoftimit të datës 11.10.2023.

Me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e nenit 61 paragrafi 3 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se: *"3. Vlerësimi maksimal për jetëshkrimin është deri njëzet (20) pikë, si vijon: 3.1. tetë (8) pikë për cilësinë dhe nivelin e arsimit; 3.2. shtatë (7) pikë për përvojën domethënëse në punë, dhe 3.3. pesë (5) pikë për trajnimet dhe kualifikimin. 4. Secili nga anëtarët e KVND, bën vlerësimin e detajuar për secilin prej faktorëve të përcaktuar në paragrafin. 3 të këtij neni. Vlerësimi është mesatarja vlerësimeve e të gjithë anëtarëve."* si dhe nenin 48 ndërlidhur me nenin 63 të së njëjtës rregullore ku përcaktohet se: *"Çdo anëtarë i KVLBK jep pikët e tij në mënyrë individuale pas vlerësimit sipas nenit 47 të kësaj rregullore. Pikët e çdo anëtari për çdo vlerësim mbliidhen dhe pjesëtohen me pesë. 2.Në përfundim të fazës të vlerësimit, pikët e përfituara nga secili kandidat në secilën nga hapat e vlerësimit, mbliidhen dhe shuma e pikëve për të gjithë hapat e vlerësimit përbën vlerësimin përfundimtar të konkurrimit"* dhe erdhi në përfundimin se Komisioni i vlerësimit ka dështuar të zbatoi drejtë dispozitat e lartcekura të rregullores në fjalë pasi që për Kolegjin e Këshillit ka qenë e paqartë formula e ndjekur e poentimit nga ana e Komisionit të Vlerësimit se mbi çfarë baze apo në çfarë mënyre ankuesi është vlerësuar me 4 pikë për jetëshkrimin pavarësisht faktit se Këshill përmes kërkesës për përgjigje të datës 15.11.2023 ku ndër të tjera ka kërkuara: *"Formularin e vlerësimit për jetëshkrimin dhe intervistën me gojë nga të gjithë anëtarët e komisionit"* mirëpo të njëjtit formularë nuk janë sjellë përmes përgjigjes së datës 20.11.2023, mirëpo është sjellë vetëm formulari i renditjes përfundimtare, nga rrjedh se ka munguar transparenca e poentimit individual e çdo anëtari sikurse përcaktohet me dispozitat e nenit 48 ndërlidhur me nenin 63 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës

Kolegji i Këshill sjell në vëmendje faktin se dispozitat e nenit 61 paragrafi 3 të Rregullores (QRK)

Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës kanë përcaktuar qartë se lidhur me vlerësimin e jetëshkrimit, pikët maksimale që mund t'i ipen një kandidati në procedura janë si vijon: tetë (8) pikë për cilësinë dhe nivelin e arsimit, shtatë (7) pikë për përvojën domethënëse në punë dhe 3 pesë (5) pikë për trajnimet dhe kualifikimin, prandaj duhet të ketë arsye të qëndrueshme dhe vendim apo konstatim të arsyetuar drejtë për tu vlerësuar ndryshe një kandidatë në procedurë, të paktën lidhur me cilësinë dhe nivelin e arsimit dhe për përvojën domethënëse në punë për aq kohë sa njësia përgjegjëse në fazën e verifikim paraprak ka konstatuar se kandidati apo ankuesi në këtë rast i ka plotësuar kriteret e konkursit të datës 26.01.2023 lidhur me kualifikimin profesional dhe përvojën e punës, ndërsa në rrethanat e rastit konkret vlerësimi i jetëshkrimit me 4 pikë nga ana e Komisionit të Pranimi është i pa mbështetje ligjore ngase i njëjti vlerësim nuk është i arsyetuar, gjegjësisht Komisioni i Vlerësimit me këtë përfundim ka kontestuar në mënyrë indirekte edhe plotësimin e kriterëve të konkursit nga ana e ankuesit e që është jashtë mandatit të tij ligjor.

Prandaj nga se u tha si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi, Kolegji i Këshillit arriti në përfundimin se ankesa e ankuesit e datës 08.11.2023 është e bazuar, ndërsa veprimet procedural të Komisionit të vlerësimit me rastin e rivlerësimit të jetëshkrimit dhe intervistës me gojë janë në kundërshtim me parimet e përgjithshme të pranimit të përcaktuara me nenin 6 paragrafi 1 dhe të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *"Pranimi në detyrë i nëpunësit civil, nëpunësit të Shërbimit Publik dhe nëpunësit administrativo teknik dhe mbështetës, bazohet në parimet e mundësive të barabarta, meritës dhe integritetit, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe proporcional gjinor dhe të komuniteteve. 2. Pranimi, sipas paragrafit 1 të këtij neni, kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës profesional, transparent e të drejtë, që garanton mundësi të barabarta për kushte të barabarta dhe përzgjedhjen e kandidatëve më të kualifikuar për kryerjen e detyrave përkatëse, duke garantuar përfaqësimin minimal të komuniteteve dhe të gjinive"*, nga rrjedh se Kolegji i Këshillit mori vendim si në dispozitivin e këtij vendimi që të anulohen Njoftimi i datës 11.10.2023, i Njesisë së Burimeve Njerëzor si dhe rezultatet përfundimtare të vlerësimit të datës 09.11.2023, ndërsa mbesin në fuqi veprimet administrative të ndërmarra në procedurën paraprake deri tek testin me shkrim, kurse lënda kthehet në Komisionin e vlerësimit të cilët me rastin e rishqyrtimit të vlerësimit të jetëshkrimit dhe intervistës me gojë detyrohen të marrën përbazë pikëpamjet dhe vërejtjet e dhëna juridike sikurse në arsyetimin e këtij vendimin ndërlidhur me zbatimin e drejtë të normë së ligjit material respektivisht nenit 61 paragrafi 3 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Komisioni i Vlerësimit për Ngritje në Detyrë i cili është i themeluar me Vendimin Nr.Ref.02/72 të datës 14.03.2023 në përbërje nga \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_ me rastin e rishqyrtimit të vlerësimit të ankuesit që ndërlidhet me vlerësimin e jetëshkrimit dhe intervistës me gojë duhet të ketë parasysh faktin se sipas nenit 46 paragrafi 1 dhe 3 nën paragrafi 3.10 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *"1. Shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore. 3. Shkelje të rënda konsiderohen. 3.10. Shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi"*, andaj mos respektimi i detyrimeve për të zbatuar drejtë dispozitat e ligjit material lidhur me procedurat e rekrutimit përbën shkelje ligjore, ndërsa sipas nenit 21 paragrafi 1 dhe nenit 24 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ku përcaktohet se: *"21.1 Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës. 24.1 . Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit sipas nenit 21 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit nxjerr vendim për ndalimin e 50 % të pagës mujore*

për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit." zyrtarët të cilat janë përgjegjës sikurse në dispozitivin e këtij vendimi për zbatimin e tij, mund të paralizohen sipas legjislacionit në fuqi për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nëse nuk veprojnë në pajtueshmëri me pikëpamjet juridike të këtij vendimi.

Kolegji i Këshillit, bazuar në konstatimet dhe rrethanat si me sipër, e në mbështetje të nenit 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenit 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** *Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.*

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1393/2023

**Flakron GASHI**

*Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional*



**Eshref SHABANI**

*Kryetar i Kolegjit*

### Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.